# ГЛАСИЛО
# GAZETË

Март / Април 2025
Mars / Prill 2025



**ЗЕЛС**
**ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

**BNJVL**
**BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**



Почитувани,

На 16 март 2025 година, нашата земја се соочи со ужасната трагедија што се случи во Кочани. Пожарот што избувна во кабаре, одзема 61 невин млад живот. ЗЕЛС веднаш им изрази сочувство на семејствата и пријателите на загинатите, а на повредените им посака брзо закрепнување. Во овој број на Гласило на ЗЕЛС сакаме уште еднаш да изразиме длабока жалост и да потсетиме дека ЗЕЛС им дава силна поддршка на органите на прогонот да ги утврдат причините за трагедијата и да ги соопштат на најтранспарентен начин, за вакво нешто никогаш и никаде да не се повтори.

Во периодот март – април, ЗЕЛС реализираше повеќе активности за јакнење на капацитетите на општинската администрација во областа на образованието, животната средина, јавните набавки и социјалата, а одржа и средби со повеќе министри од Владата на РСМ. Управниот одбор на ЗЕЛС, во овој период, одржа две седници на кои главните точки од дневниот ред беа поврзани со трагичниот настан и преземањето превентивни мерки што се во надлежност на локалната власт. Беа извршени низа инспекциски надзори за проверка на документацијата и опремата за безбедност и заштита во јавните објекти, особено во училиштата и градинките, но исто така, беа преземени одредени мерки и насоки во однос на станбеното домување. Од извршените контроли беше утврдено дека најголеми предизвици и неправилности се забележани во угостителските објекти, кај поставувањето на урбаната опрема, за што беа преземени дополнителни чекори. Во таа насока, беа изречени опомени за во определен рок да се изврши усогласување со постојната регулатива, а претставниците од ЗЕЛС имаа и средба со министерот за транспорт, Александар Николоски, на која се бараше да се донесе правилник за поставување на урбана опрема со стандарди и нормативи што ќе бидат унифицирани на ниво на целата држава.

Претседателството на ЗЕЛС имаше средба и со првиот заменик-претседател на Владата на РСМ и министер за животна средина и просторно планирање Изет Меџити, на која се отвори поширока дискусија за унапредување на децентрализацијата во земјата, обезбедување на поголема финансиска стабилност на општините и за последниот повик на МЖСПП за аплицирање на општините за проекти за канализациска и водоводна инфраструктура. Делегацијата од ЗЕЛС имаше средба и со министерката за финансии Гордана Димитриеска-Кочоска, за итно изнаоѓање решенија за финансиските предизвици со кои се соочуваат јавните претпријатија, основани од општините, но и за други прашања поврзани со финансирањето на општините. Посебно беше упатено барање за итно разрешување на предизвиците со финансирањето, опремувањето и екипираноста на територијалните противпожарни единици, но и за недостатокот на финансиски средства во образованието и градинките. Во овој период, претседателот на ЗЕЛС, Орце Ѓорѓиевски, имаше средба и со министерот без ресор во Владата на РСМ, Шабан Салиу, задолжен за интеграција и имплементација на Стратегијата за инклузија на Ромите 2022 – 2030, на која се дискутираше за унапредувањето на интеграцијата на ромската популација. За овие и за други настани подетално ќе можете да прочитате во овој број на Гласилото на ЗЕЛС.

Со почит,

Душица Перишиќ,
извршен директор на ЗЕЛС

Të nderuar,

Më 16 mars 2025, vendi ynë u përball me tragjedinë e tmerrshme që ndodhi në Koçan. Zjarri që shpërtheu në një kabare mori jetën e 61 të rinjve të pafajshëm. BNJVL menjëherë shprehu ngushëllime familjeve dhe miqve të të ndjerit dhe u uroi shërim të shpejtë të lënduarve. Në këtë numër të Gazetës së BNJVL-së, dëshirojmë të shprehim edhe një herë ngushëllimet tona të thella dhe t'ju kujtojmë se BNJVL jep mbështetje të fortë për organet e zbatimit të ligjit për të konstatuar shkaqet e tragjedisë dhe për t'i publikuar ato në mënyrën më transparente, me qëllim që diçka e këtillë të mos ndodhë më kurrë dhe askund.

Në periudhën mars-prill, BNJVL zbatoi më shumë aktivitete për forcimin e kapaciteteve të administratës komunale në fushat e arsimit, mjedisit jetësor, prokurimeve publike dhe mirëqenies sociale, dhe gjithashtu mbajti takime me disa ministra të Qeverisë së RMV-së. Bordi drejtues i BNJVL-së mbajti dy seanca gjatë kësaj periudhe, në të cilat pikat kryesore të rendit të ditës kishin të bënin me ngjarjen tragjike dhe ndërmarrjen e masave parandaluese që janë në kompetencë të pushtetit lokal. U kryen një sërë mbikëqyrjesh inspektuese për të kontrolluar dokumentacionin dhe pajisjet për sigurinë dhe mbrojtjen në objektet publike, veçanërisht në shkollat dhe kopshtet e fëmijëve, por gjithashtu u morën edhe masa dhe udhëzime të caktuara në fushën e banimit banesor. Nga kontrollet e kryera u konstatua se sfidat dhe parregullsitë më të mëdha janë vërejtur në objektet hoteliere, instalimin e pajisjeve urbane, për të cilat u ndërmorën hapa shtesë. Në këtë drejtim, u dhanë paralajmërime që të bëhen harmonizime me rregulloret ekzistuese për një periudhe të caktuar kohore, ndërsa përfaqësuesit e BNJVL-së patën takim edhe me Ministrin e Transportit, Aleksandar Nikolloski, në të cilin u kërkua të miratohet një rregullore për instalimin e pajisjeve urbane me standarde dhe norma që do të unifikohen në nivel të të gjithë vendit.

Kryesia e BNJVL-së pati takim edhe me Zëvendës-kryeministrin e parë të Qeverisë së RMV-së dhe Ministër të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Izet Mexhiti, në të cilin u hap një diskutim më i gjerë për avancimin e decentralizimit në vend, sigurimin e një stabiliteti më të madh financiar të komunave dhe thirrjen e fundit të MMJPH-së për komunat për të aplikuar për projekte të infrastrukturës së kanalizimit dhe ujësjellësit. Delegacioni i BNJVL-së pati takim edhe me Ministren e Financave, Gordana Dimitrieska-Koçoska, për të gjetur urgjentisht zgjidhje për sfidat financiare me të cilat ballafaqohen ndërmarrjet publike të themeluara nga komunat, por edhe për çështje të tjera që lidhen me financimin e komunave. U bë një kërkesë e veçantë për një zgjidhje urgjente të sfidave me financimin, pajisjen dhe personelin e njësive territoriale të zjarrfikësve, si dhe mungesën e mjeteve financiare në arsimin dhe kopshtet e fëmijëve. Gjatë kësaj periudhe, Kryetari i BNJVL-së, Orce Gjorgjievski, pati takim edhe me Ministrin pa resor në Qeverinë e RMV-së, Shaban Saliu, përgjegjës për integrimin dhe zbatimin e Strategjisë për Përfshirjen e Romëve 2022-2030, në të cilin u diskutua për avancimin e integrimit të popullsisë rome. Për këto dhe ngjarje të tjera mund të lexoni më hollësisht në këtë numër të Gazetës së BNJVL-së.

Me respekt,

Dushica Perishiq ,
Drejtoreshë ekzekutive e BNJVL-së


**ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛН АТА САМОУПРАВА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

тел. +389 (0) 2 30 99 033
ул. Копенхагенска бр. 5, п.фах 32,
1000 Скопје, Република Северна Македонија

**Извршен директор на ЗЕЛС:**
Душица Перишиќ
**Заменик извршен директор на ЗЕЛС:**
Ардита Дема Мехмети
**Подготвила:** Весна Арсовска-Динковска
**Превод:** Славе Чорбев
**Лекторирал:** Валентина Великова
**Дизајн и подготовка:** Никола Тодоровски, Карина Доневска

**BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

tel. +389 (0) 2 30 99 033
rr. Kopenhagenska nr. 5, F.P. 32,
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

**Drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:**
Dushica Perishiq
**Zëvendës drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:**
Ardita Dema Mehmeti
**Përgatiti:** Vesna Arsovska-Dinkovska
**Përkthim:** Sllave Çorbev
**Lektoron:** Valentina Velikova
**Dizajnim dhe përgatitje:** Nikola Todorovski, Karina Donevska

## СОЧУВСТВО ОД ЗЕЛС ЗА СЕМЕЈСТВАТА И БЛИСКИТЕ НА ЖРТВИТЕ ОД ТРАГЕДИЈАТА ВО КОЧАНИ

Заедницата на единиците на локалната самоуправа на Република Северна Македонија со длабока тага изразува жалење за страотниот пожар во Кочани кој однесе премногу млади животи, синови и ќерки на оваа земја. На семејствата на жртвите и на нивните блиски им изразуваме длабоко сочувство за огромната загуба, а на повредените што поскоро да закрепнат.

Изгубивме младина која само што започна да ја гради својата и иднината на нашата земја. Млади луѓе на кои им се воодушевувавме на нивниот ентузијазам и сила. Тие беа нашата гордост и нашата верба дека нè чека светла иднина. Загубата е ненадоместлива, а тагата многу длабока. Затоа ЗЕЛС им дава силна поддршка на органите на прогонот да ги утврдат причините за трагедијата и да ги соопштат на најтранспарентен начин, за вакво нешто никогаш и никаде да не се повтори.

Почивајте во мир, наши млади ангели!

## NGUSHËLLIME NGA BNJVL PËR FAMILJET DHE TË AFËRMIT E VIKTIMAVE TË TRAGJEDISË NË KOÇAN

Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale e Republikës së Maqedonisë së Veriut me pikëllim të thellë shpreh keqardhje për zjarrin e tmerrshëm në Koçan, i cili mori shumë jetë të reja, djem dhe vajza të këtij vendi. Ua shprehim ngushëllimet tona më të thella familjeve të viktimave dhe të afërmve të tyre për humbjen e tyre të madhe, ndërsa të lënduarve u urojmë shërim të shpejtë.

Humbëm të rinjtë që sapo kishin filluar të ndërtonin të ardhmen e tyre dhe të vendit tonë. Njerëz të rinj, entuziazmin dhe forcën e të cilëve e admironim. Ata ishin krenaria dhe besimi ynë se na pret një e ardhme e ndritshme. Humbja është e pariparueshme, ndërsa pikëllimi është shumë i thellë. Prandaj, BNJVL-ja fuqimisht i përkrah organet e rendit që t'i identifikojnë shkaqet e tragjedisë dhe t'i publikojnë të njëjtat në mënyrë sa më transparente që diçka e këtillë të mos përsëritet më askund.

Prehuni në paqe engjëjt tanë të rinj!



# „РЕГИОНАЛНАТА СОРАБОТКА Е ПОТРЕБА, А НЕ ОПЦИЈА“ – ГЛАВЕН ЗАКЛУЧОК ОД КОНФЕРЕНЦИЈАТА ВО ТИРАНА

„Синергија меѓу локалните самоуправи за регионална соработка и интеграција во ЕУ“ беше насловот на конференцијата што се одржа од 5 до 7 март 2025 во Тирана, (Албанија) на која, како претставници од ЗЕЛС, присуствуваа градоначалникот на Општина Тетово, Билал Касами и градоначалникот на Општина Прилеп, Борче Јовчески. Во присуство на бројни градоначалници од земјите од Западен Балкан, министри, претставници од граѓанскиот сектор, од регионални и меѓународни организации и фондови беа презентирани добри примери од локалната самоуправа и се водеа дискусии на повеќе теми: реформа на локалната самоуправа во процесот на интеграција во Европската Унија; регионална соработка и одржлив локален развој; локално управување и економски развој; поттикнување на регионална соработка и добро владеење преку граѓанско учество и иновативни стратегии за финансирање на одржлив раст во градовите од Западен Балкан.

## Презентирани добри примери на општините Тетово и Прилеп

Градоначалникот на Општина Тетово, Билал Касами, говореше за важноста на европските и на меѓународните фондови за општините во насока на развивање на инфраструктурата, локалниот економски развој, подигање на свеста за поголемо учество на граѓаните во градењето и донесувањето локални политики и одлуки. Тој ги претстави потенцијалите на Општина Тетово, која високо котира меѓу општините во нашата земја во поглед на активностите во економијата, образованието, културата и друго. За мотивирањето на граѓаните и невладините организации да бидат проактивни во процесите на носење одлуки во заедницата, што е голем предизвик за секоја локална самоуправа, говореше градоначалникот на Општина Прилеп, Борче Јовчески. Тој посочи дека секоја општина треба да утврди сопствена стратегија, но дека во неговата општина најмногу се практикува директна комуникација со граѓаните; формирање на дигитални платформи за партиципативно буџетирање и се организираат редовни консултации при изготвувањето

# “BASHKËPUNIMI RAJONAL ËSHTË NEVOJË, E JO OPSION” – KONKLUZION KRYESOR NGA KONFERENCA NË TIRANË

“Sinergjia ndërmjet vetëqeverisjeve lokale për bashkëpunim rajonal dhe integrim në BE” ishte titulli i konferencës që u mbajt nga 5 deri më 7 mars 2025 në Tiranë (Shqipëri) në të cilën, si përfaqësues të BNJVL-së, morën pjesë Kryetari i Komunës së Tetovës, Bilall Kasami dhe Kryetari i Komunës së Prilepit, Borçe Jovçeski. Në prani të kryetarëve të shumtë të komunave nga vendet e Ballkanit Perëndimor, ministrave, përfaqësuesve të shoqërisë civile, organizatave dhe fondeve rajonale dhe ndërkombëtare, u prezantuan shembuj të mirë të vetëqeverisjes lokale dhe u zhvilluan diskutime për më shumë tema: reforma e vetëqeverisjes lokale në procesin e integrimit në Bashkimin Evropian, bashkëpunimi rajonal dhe zhvillimi i qëndrueshëm lokal, qeverisja lokale dhe zhvillimi ekonomik, nxitja e bashkëpunimit rajonal dhe qeverisjes së mirë përmes pjesëmarrjes së qytetarëve dhe strategjive inovative për financimin e rritjes së qëndrueshme në qytetet e Ballkanit Perëndimor.

## Prezantohen shembuj të mirë të komunave të Tetovës dhe Prilepit

Kryetari i Komunës së Tetovës, Bilall Kasami, foli për rëndësinë e fondeve evropiane dhe ndërkombëtare për komunat në drejtim të zhvillimit të infrastrukturës, zhvillimit ekonomik lokal, ngritjes së vetëdijes për një pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në ndërtimin dhe marrjen e politikave dhe vendimeve lokale. Ai prezantoi potencialet e Komunës së Tetovës, e cila renditet lart midis komunave në vendin tonë për sa i përket aktiviteteve në ekonomi, arsim, kulturë etj. Për motivimin e qytetarëve dhe organizatave joqeveritare për të qenë proaktivë në proceset e vendimmarrjes në komunitet, gjë që është një sfidë e madhe për çdo vetëqeverisje lokale foli Kryetari i Komunës së Prilepit, Borce Jovçeski. Ai theksoi se secila komunë duhet të përcaktojë strategjinë e vet, por se në komunën e tij komunikimi i drejtpërdrejtë me qytetarët praktikohet më së shumti; formimi i platformave digjitale për buxhetimin pjesëmarrës dhe organizohen konsultime të rregullta gjatë përgatitjes së dokumenteve strategjike. Sipas Jovçeskit, komunat duhet të forcojnë bashkëpunimin rajonal si






стратегиски документи. Според Јовчески, општините треба да ја зајакнат регионалната соработка како важен дел од процесот на евроинтеграција, особено преку заеднички активности на прекуграничните проекти, размена на добри примери и креирање на заеднички политики со цел да се постигне подобра усогласеност со стандардите на ЕУ. Како добра практика за обезбедување на посилно партнерство на општината со граѓанските организации, тој ја нагласи важноста од формирање на заеднички координативни тела со граѓанските организации, спроведување на обуки, градење на административни капацитети и создавање на фондови за поддршка на проекти. Јовчевски предложи создавање на платформа за редовна комуникација меѓу локалната самоуправа, граѓанските организации и стопанството. На крајот од излагањето тој посочи дека заедниците на локалната самоуправа во земјите од Западен Балкан се многу важен инструмент на општините бидејќи преку нив се обезбедува предизвиците на локалната власт да се издигнат на повисоко ниво и преку партнерски дијалог со централната власт да се иницираат мерки за нивно решавање.

## Локалните самоуправи играат клучна улога во усогласувањето на реформите со стандардите на ЕУ

„Треба заедно да седнат централната и локална власт и да ги решаваат предизвиците. Очекувањата на граѓаните се зголемуваат и доколку не се реализираат, тие се таложат и го зголемуваат притисокот врз локалните власти. Фискалната кондиција е многу ограничена, што може да се реши само со повеќестепено владеење", нагласи Келменд Зајази, извршен директор на НАЛАС.

Шефот за соработка на Делегацијата на ЕУ во Тирана, Хуберт Пер, на конференцијата ја нагласи потребата од регионалната соработка, за која рече дека не е опција, туку потреба, што впрочем беше и главниот заклучок од овој настан. Локалните самоуправи играат клучна улога во усогласувањето на реформите со стандардите на ЕУ преку засилена децентрализација и иновативно управување.

„Не треба да измислуваме, туку треба да градиме синергија од тоа што ни е на располагање за да го направиме најдоброто. Европската Унија има многу инструменти на располагање што имаат регионална димензија: ИПА прекугранична соработка, Паметни градови, ИНТЕРЕГ итн., преку кои се прави поврзувања во регионот", нагласи Хуберт Пер.

një pjesë e rëndësishme e procesit të integrimit evropian, veçanërisht përmes aktiviteteve të përbashkëta në projekte ndërkufitare, shkëmbimit të shembujve të mirë dhe krijimit të politikave të përbashkëta me qëllim arritjen e një përputhshmërie më të mirë me standardet e BE-së. Si një praktikë e mirë për të siguruar një partneritet më të fortë të komunës me organizatat e shoqërisë civile, ai theksoi rëndësinë e krijimit të trupave të përbashkët koordinues me organizatat e shoqërisë civile, zbatimit të trajnimeve, ndërtimit të kapaciteteve administrative dhe krijimit të fondeve për të mbështetur projektet. Jovçevski propozoi krijimin e një platforme për komunikim të rregullt midis vetëqeverisjes lokale, organizatave të shoqërisë civile dhe bizneseve. Në fund të prezantimit të tij, ai theksoi se bashkësitë e vetëqeverisjes lokale në vendet e Ballkanit Perëndimor janë një instrument shumë i rëndësishëm i komunave, sepse përmes tyre sigurohet që sfidat e pushtetit lokal të ngrihen në një nivel më të lartë dhe që masat për zgjidhjen e tyre të iniciohen përmes një dialogu partneriteti me pushtetin qendror.

## Vetëqeverisjet lokale luajnë rol kryesor në harmonizimin e reformave me standardet e BE-së

“Pushteti qendror dhe ai lokal duhet të ulen së bashku dhe t'i zgjidhin sfidat. Pritjet e qytetarëve janë në rritje dhe nëse nuk realizohen, ato grumbullohen dhe rrisin presionin mbi autoritetet lokale. Kondicioni fiskal është shumë i kufizuar, gjë që mund të zgjidhet vetëm me qeverisje shumënivelëshe”, theksoi Kelmend Zajazi, drejtor ekzekutiv i NALAS- it.

Shefi i Bashkëpunimit të Delegacionit të BE-së në Tiranë, Hubert Per, theksoi në konferencë nevojën për bashkëpunim rajonal, për të cilin ai tha se nuk është opsion, por nevojë, gjë që në fakt ishte edhe përfundimi kryesor i kësaj ngjarjeje. Vetëqeverisjet lokale luajnë një rol kyç në harmonizimin e reformave me standardet e BE-së përmes decentralizimit të përforcuar dhe qeverisjes inovative.

“Nuk duhet të shpikim, por të ndërtojmë sinergji nga ajo që kemi në dispozicion për të bërë më të mirën. Bashkimi Evropian ka në dispozicion shumë instrumente që kanë një dimension rajonal: bashkëpunimi ndërkufitar IPA, Qytetet e mençura, INTEREG-u, etj., përmes të cilave krijohen lidhje në rajon”, theksoi Hubert Per.





## Конференцијата дел од повеќегодишните тематски настани на Фондот за Западен Балкан (WBF)

Конференцијата „Синергија меѓу локалните самоуправи за регионална соработка и интеграција во ЕУ" е дел од повеќегодишните тематски настани на Фондот за Западен Балкан (WBF). Фондот за Западен Балкан е меѓународна организација формирана од владите на Албанија, Босна и Херцеговина, Косово, Македонија, Црна Гора и Србија. Мисијата е да ја поттикне регионалната соработка и интеграцијата во ЕУ преку ангажирање на локални лидери кои се справуваат со предизвиците како што се демографските промени и општествената кохезија.

Конференцијата СИНЕРГИЈА 2025 е организирана од Фондот за Западен Балкан (WBF) во партнерство со Министерството за надворешни работи на Јапонија, Меѓународниот вишеградски фонд, НАЛАС и РеСПА. Ова е дел од иницијативата Јапонија-Западен Балкан, покрената од починатиот премиер Шинзо Абе во 2018 година и се надоврзува на претходните активности фокусирани на толеранција, женско лидерство и дезинформации.

## Konferenca pjesë e ngjarjeve shumëvjeçare tematike të Fondit të Ballkanit Perëndimor (WBF)

Konferenca "Sinergjia ndërmjet vetëqeverisjeve lokale për bashkëpunim rajonal dhe integrim në BE" është pjesë e ngjarjeve shumëvjeçare tematike të Fondit të Ballkanit Perëndimor (WBF). Fondi i Ballkanit Perëndimor është një organizatë ndërkombëtare e formuar nga qeveritë e Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Misioni është të nxisë bashkëpunimin rajonal dhe integrimin në BE duke angazhuar liderë lokalë të cilët ballafaqohen me sfidat siç janë ndryshimet demografike dhe kohezioni shoqëror.

Konferenca SINERGJIA 2025 organizohet nga Fondi i Ballkanit Perëndimor (WBF) në partneritet me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Japonisë, Fondin Ndërkombëtar të Vishegradit, NALAS dhe ReSPA. Kjo nismë është pjesë e Iniciativës Japoni-Ballkani Perëndimor, e nisur nga Kryeministri i ndjerë Shinzo Abe në vitin 2018 dhe bazohet në aktivitetet e mëparshme të fokusuara në tolerancën, udhëheqjen e grave dhe dezinformatave.

## СО РАЗМЕНА НА ИСКУСТВА ДО ПОДОБРЕНА ЕФИКАСНОСТ, ПРЕДИЗВИК ЗА ПРОСВЕТНИТЕ ОПШТИНСКИ ИНСПЕКТОРИ

Просветните инспектори од општините одржаа работилница во просториите на ЗЕЛС тренинг центарот, на 19 март 2025 година, на која дискутираа за актуелните предизвици со кои се соочуваат во спроведувањето на постапките во инспекцискиот надзор. Со едноминутно молчење, на почетокот на средбата, тие им оддадоа почит на жртвите од трагичниот настан предизвикан од пожарот што избувна во дискотеката во Кочани.

Општинските просветни инспектори нагласија дека овој вид споделување на искуства и предизвици со кои се соочуваат при имплементирањето на законските прописи е од големо значење за ефикасно спроведување на инспекциските надзори во образовните установи. Во таа насока тие се договорија во иднина секој инспектор доброволно да се пријави и да елаборира искуства од инспектори. Исто така, се договорија да изработат план со

## ME SHKËMBIM TË PËRVOJAVE DERI TE EFIKASITETI MË I MIRË, SFIDË PËR INSPEKTORËT KOMUNALË TË ARSIMIT

Inspektorët e arsimit nga komunat mbajtën një punëtori në hapësirat e Qendrës së Trajnimeve të ZELS-it më 19 mars 2025, në të cilën diskutuan për sfidat aktuale me të cilat ballafaqohen në zbatimin e procedurave të mbikëqyrjes inspektuese. Me një minutë heshtje në fillim të takimit, ata u bënë homazhe viktimave të ngjarjes tragjike të shkaktuar nga zjarri që shpërtheu në diskotekën në Koçan.

Inspektorët komunalë të arsimit theksuan se ky lloj shkëmbimi i përvojave dhe sfidave me të cilat ballafaqohen në zbatimin e rregullave ligjore është me rëndësi të madhe për zbatimin efikas të mbikëqyrjeve inspektuese në institucionet arsimore. Në këtë drejtim, ata ranë dakord që në të ardhmen, çdo inspektor të paraqitet në mënyrë vullnetare dhe të japë hollësi për përvojat nga një mbikëqyrje e caktuar për të cilën





одреден надзор, за кој смета дека најдобро го совладал, со цел стекнатите знаења да ги пренесе на останатите повеќе теми за работилници што ќе ги реализираат во ЗЕЛС во текот на една година, а што ќе кореспондира со законските обврски што треба да ги преземаат образовните установи. Целта е да им се помогне на училиштата, односно тие навремено да бидат информирани за правилно реализирање на нивните законски обврски, но, исто така, да се обезбеди и одредена унифицираност во постапувањето во општините.

На овој состанок, просветната инспекторка од Општина Велес, Македонка Власова, презентираше три студии на случај и тоа за проверките на валидноста на изборот на органите на управување на училиштето, потоа за соодветното архивирање на одредени документи и последната студија се однесуваше на начинот и постапките за спроведување на училишните екскурзии. На работилницата се говореше и за одредени активности поврзани со запазување на хигиената во училиштата и систематските прегледи на вработените и слично, а стана збор и за претстојните матурски вечери.

За следна тема беше посочена постапката за претстојните уписи на ученици во прво одделение, опфатот на ученици по реонизација во општината, а стана збор и за потребата на средби со претставници од Министерството за образование и наука за дообјаснување на пропусти за одредени законски одредби, со цел нивна соодветна имплементација. Присутните посочија дека е потребно бројот на општински просветни инспектори континуирано да се зголемува, при што беше посочена и можноста за склучување на меѓу-општинска соработка, но, исто така, беа изнесени и неофицијални сознанија за иницирање на регионализација на инспекцискиот надзор. На крајот од средбата инспекторите ѝ се заблагодарија на ЗЕЛС за поддршката и за укажаната можност за продолжување на овие активности и во следниот период.

mendon se e ka kryer më së miri, me qëllim që njohuritë e fituara t'ua transferojë inspektorëve të tjerë. Ata gjithashtu ranë dakord të hartojnë një plan me disa tema për punëtori që do t'i zbatojnë në BNJVL gjatë një viti, të cilat do të korrespondojnë me obligimet ligjore që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore. Qëllimi është të ndihmohen shkollat, gjegjësisht të informohen ato në kohën e duhur për zbatimin e drejtë të obligimeve të tyre ligjore, por edhe të sigurohet një uniformitet i caktuar në veprimet e ndërmarra nga komunat.

Në këtë takim, inspektorja e arsimit nga Komuna e Velesit, Dr. Makedonka Vllarova, prezantoi tre studime rastesh për kontrollimet e vlefshmërisë së zgjedhjes së organeve drejtuese të shkollës, pastaj për arkivimin përkatës të dokumenteve të caktuara dhe studimin e fundit që lidhet me mënyrën dhe procedurat për kryerjen e ekskursioneve shkollore. Në punëtori u diskutuan gjithashtu aktivitete të caktuara që lidhen me ruajtjen e higjienës në shkolla dhe ekzaminimet sistematike të punonjësve dhe të ngjashme, ndërsa u bë fjalë edhe për mbrëmjet e ardhshme të maturës.

Për temën e radhës ishte theksuar procedura për regjistrimin e ardhshëm të nxënësve në klasën e parë, përfshirja e nxënësve pas rajonalizimit në komunë dhe nevoja për takime me përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të sqaruar lëshimet për dispozita të caktuara ligjore, me qëllim të zbatimit të tyre përkatës. Të pranishmit theksuan se numri i inspektorëve komunalë të arsimit duhet të rritet vazhdimisht, si dhe u theksua mundësia e vendosjes së bashkëpunimit ndërkomunal, por u prezantuan edhe informacione jozyrtare për inicimin e rajonalizimit të mbikëqyrjes inspektuese. Në fund të takimit, inspektorët falënderuan BNJVL-në për mbështetjen dhe për mundësinë e ofruar për të vazhduar këto aktivitete në periudhën e ardhshme.

## РЕАЛИЗИРАНА ОБУКА ЗА ОПШТИНСКАТА АДМИНИСТРАЦИЈА ЗА ИМПЛЕМЕНТИРАЊЕ НА ЗАКОНСКИТЕ ИЗМЕНИ ВО ЈАВНИТЕ НАБАВКИ

Бирото за јавни набавки, на барање и во соработка со ЗЕЛС, на 21 март 2025 година спроведе онлајн обука за претставниците од општинската администрација од одделенијата за јавни набавки, со цел да се добијат насоки за примена на новите измени и дополнувања на Законот за јавните набавки, усвоени од Собранието на РСМ на 16 јануари 2025 година и објавени, како важечки прописи, во „Службен весник на РСМ“ бр. 14/2025. Измените и дополнувањата на Законот за јавни набавки се однесуваат на подобрување на законските одредби и нивно усогласување со утврдените недостатоци при неговото спроведување во изминатите шест години. Беше посочено дека дел од измените се направени во согласност со

## U REALIZUA TRAJNIMI PËR ADMINISTRATËN KOMUNALE PËR ZBATIMIN E NDRYSHIMEVE LIGJORE NË PROKURIMET PUBLIKE

Byroja e Prokurimit Publik, me kërkesë dhe në bashkëpunim me BNJVL-në, më 21 mars 2025, zbatoi trajnim online për përfaqësuesit e administratës komunale nga departamentet e prokurimeve publike me qëllim të marrjes së udhëzimeve për zbatimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të reja në Ligjin e prokurimeve publike, të miratuara nga Kuvendi i RMV-së më 16 janar 2025 dhe të publikuara si rregulla të vlefshme në "Gazetën zyrtare të RMV-së" nr. 14/2025. Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit të prokurimeve publike kanë të bëjnë me përmirësimin e dispozitave ligjore dhe harmonizimin e tyre me mangësitë e evidentuara gjatë zbatimit të tij në gjashtë vitet e kaluara. U theksua se një pjesë

постигнувањето на реформските цели, што произлегуваат од Планот за раст на земјите од Западен Балкан, утврден од Европската Унија. Овие реформски цели во делот на јавни набавки ќе се спроведуваат етапно, во следните три години. Прво треба да се намали процентот на користењена електронските аукции најмногу до 40 % од вкупните јавни набавки, потоа, да се поттикне користење на електронски пазар за набавка од мала вредност и најсложените реформи се планираат за последната година, кога треба да се зголеми процентот на постапки каде што критериумот за избор на најповолна понуда ќе се утврдува како најдобар однос помеѓу цената и квалитетот.

## Нови надлежности на БЈН, новини во поништување на постапката, во правната заштита, воведување на административна проверка...

Во фокусот на оваа обука беа темите што се однесуваа на измените поврзани со определени нови надлежности на Бирото за јавни набавки; новите основи за поништување на постапката; новините во правната заштита и значењето на новата административна проверка која се воведува како замена на досегашната управна контрола на постапките за јавни набавки. Од особена важност за присутните беше и презентирањето на новите функционалности на Електронскиот систем на јавни набавки (ЕСЈН), чија примена ќе започне од 1 април 2025 година. Од овој датум ќе се применува и административната проверка (АП) на постапките за јавни набавки. Предмет на административна проверка задолжително ќе бидат јавните набавки чија проценета вредност е над 500 000 евра во денарска противвредност, кај набавките на стоки и услуги и над 2 000 000 евра во денарска противвредност кај набавките на работи. Бирото за јавни набавки може да врши административна проверка и на која било јавна набавка врз основа на следење на воспоставените индикатори на ризици во јавните набавки и по случаен избор. При извршена административна проверка, БЈН дава препораки кои ќе бидат советодавни, односно на договорниот орган останува да одлучи дали ќе ги прифати препораките или не. Предмет на административна постапка ќе биде огласот за јавна набавка и тендерската документација, и нивната проверка ќе се спроведува пред тие да бидат објавени. Беше посочено дека во согласност со законските измени, во тек е и спроведувањето на промените во составот на Државната комисија за жалби по јавни набавки. Таа се проширува со два члена и станува седумчлена комисија, а проширени се и основите за разрешување на членовите од страна на Собранието на РСМ.

На обуката се говореше како треба да се постапува во поедноставената отворена постапка, кога понудата на економскиот оператор е оценета за најповолна, а не биле доставени документите за утврдување на способност во определениот рок од страна на комисијата за јавни

e ndryshimeve janë bërë në përputhje me arritjen e objektivave reformuese, të cilat dalin nga Plani i rritjes i vendeve të Ballkanit Perëndimor, të përcaktuar nga Bashkimi Evropian. Këto objektiva reformuese që kanë të bëjnë me prokurimet publike do të zbatohen në faza, në tre vitet e ardhshme. Së pari duhet të ulet përqindja e përdorimit të ankandeve elektronike më së shumti deri në 40% të prokurimeve publike totale, pastaj, të nxitet përdorimi i tregut elektronik të prokurimeve me vlerë të ulët dhe reformat më komplekse planifikohen për vitin e fundit, kur duhet të rritet përqindja e procedurave ku kriteri për zgjedhjen e ofertës më të favorshme do të përcaktohet si raporti më i mirë ndërmjet çmimit dhe cilësisë.

## Kompetenca të reja të BPP-së, risi në anulimin e procedurës, në mbrojtjen juridike, aplikimin e kontrollit administrativ...

Në fokusin e këtij trajnimi ishin temat që kishin të bënin me ndryshimet e lidhura me kompetenca të caktuara të reja të Byrosë së Prokurimit Publik, bazat e reja për anulimin e procedurës, risitë në mbrojtjen juridike dhe rëndësinë e kontrollit të ri administrativ që po aplikohet si zëvendësim i kontrollit të deritanishëm administrativ të procedurave të prokurimit publik. Me rëndësi të veçantë për të pranishmit ishte edhe prezantimi i funksionaliteteve të reja të Sistemit elektronik të prokurimit publik (SEPP), zbatimi i të cilit do të nisë më 1 prill 2025. Nga kjo datë do të zbatohet edhe kontrolli administrativ (KA) i procedurave të prokurimit publik. Objekt i kontrollit administrativ domosdoshmërish do të jenë prokurimet publike, vlera e vlerësuar e të cilave është mbi 500.000 Euro në kundërvlerë të denarit për prokurimet e mallrave dhe shërbimeve dhe mbi 2.000.000 Euro në kundërvlerë të denarit për prokurimet e punëve. Byroja e Prokurimit Publik mund të kryejë kontroll administrativ për cilindo prokurim publik në bazë të monitorimit të treguesve të vendosur të rrezikut në prokurimet publike dhe me zgjidhje të rastësishme. Gjatë kontrollit të kryer administrativ, Byroja e Prokurimit Publik jep rekomandime që do të jenë këshillëdhënëse, gjegjësisht organit kontraktues i mbetet obligimi të vendosë nëse do t'i pranojë ato apo jo. Objekt i procedurës administrative do të jetë shpallja e prokurimit publik dhe dokumentacioni tenderues dhe kontrolli i tyre do të zbatohet para se të publikohen ato. U theksua se në përputhje me ndryshimet ligjore, është duke u bërë zbatimi i ndryshimeve në përbërjen e Komisionit Shtetëror për Ankesat e Prokurimit Publik. Ai po zgjerohet me dy anëtarë dhe bëhet komision shtatë anëtarësh, ndërsa zgjerohen edhe bazat për shkarkimin e anëtarëve nga ana e Kuvendit të RMV-së.

Në trajnim u diskutua se si duhet të veprohet në procedurën e hapur të thjeshtësuar, kur oferta e operatorit ekonomik vlerësohet si më e favorshme, ndërsa dokumentet për konstatimin e aftësisë nuk janë dorëzuar brenda afatit të caktuar nga komisioni i prokurimit publik. U fol edhe për

набавки. Се говореше и за проверка на документацијата и при евалуација на понудите, односно што и како треба да направи комисијата; кои се новите основи за поништување на постапка и кои се новините во правната заштита.

## Презентирана надградена верзија на ЕСЈН со нови функционалности и напредни алатки

Од 1 април 2025 година ќе се применува надградената верзија на Електронскиот систем за јавни набавки (ЕСЈН) со цел олеснување на работењето како за договорните органи, така и за економските оператори. Претставниците од Бирото за јавно набавки на обуката ги изнесоа клучните надградби на системот: автоматска тендерска документација и образец на финансиска понуда во апликацијата. Според претставниците од Бирото за јавни набавки, ќе се подобри прегледноста при измената на огласот и тендерската документација, а ќе има можност и за зачувување на примерокот, користење на предефинирани примероци и нивно автоматско вчитување. Цените за сите ставки од финансиската понуда ќе се внесуваат директно во модулот „поднеси понуда", односно нема да се прикачуваат документи за финансиска понуда, а останатите документи ќе се прикачуваат исклучиво во pdf формат. Нема да има потреба документите да се потпишуваат пред прикачување, бидејќи системот автоматски ќе аплицира дигитален потпис на ниво на апликација. Надградбата на системот треба да обезбеди да се намалат грешките и отфрлање на неуредни понуди; да се обезбеди подобра споредливост на просечните цени и анализа на пазарот; да се намалат можностите за манипулации преку автоматизација и централизирана размена на податоци и треба значително да се подобри транспарентноста на финансиските понуди; да се намали или целосно да се исклучи можноста за аритметичка грешка и да се зголеми можноста за мониторинг и анализа на податоците од страна на БЈН.

Претставниците од општинската администрација поставија бројни прашања кои се очекува да им бидат одговорени на следната обука, што ќе биде организирана од ЗЕЛС и од Бирото за јавни набавки на почетокот на следниот месец.

kontrollimin e dokumentacionit gjatë vlerësimit të ofertave, gjegjësisht çfarë dhe si duhet të bëjë komisioni, cilat janë bazat e reja për anulimin e procedurës dhe cilat janë risitë në mbrojtjen juridike.

## U prezantua versioni i përmirësuar i SEPP-it me funksionalitete të reja dhe mjete të avancuara

Nga 1 prilli 2025 do të zbatohet versioni i përmirësuar i Sistemit Elektronik të Prokurimit Publik (SEPP) me qëllim të lehtësohet puna si për organet kontraktuese ashtu edhe për operatorët ekonomikë. Përfaqësuesit e Byrosë së Prokurimit Publik prezantuan në trajnim përmirësimet kryesore të sistemit: dokumentacionin automatik tenderues dhe formularin e ofertës financiare në aplikacion. Sipas përfaqësuesve të Byrosë së Prokurimit Publik do të përmirësohet qartësia gjatë ndryshimit të shpalljes dhe dokumentacionit tenderues, si dhe do të ketë mundësi për ruajtjen e ekzemplarit, përdorimin e ekzemplarëve të paracaktuar dhe procedimin e tyre automatik. Çmimet për të gjithë artikujt e ofertës financiare do të shkruhen drejtpërdrejt në modulin "parashtro ofertën", gjegjësisht nuk do të ngarkohen dokumentet e ofertës financiare, ndërsa dokumentet e tjera do të ngarkohen ekskluzivisht në formatin pdf. Nuk do të ketë nevojë të nënshkruhen dokumentet para se të ngarkohen, sepse sistemi do të aplikojë automatikisht nënshkrim digjital në nivelin e aplikacionit. Përmirësimi i sistemit duhet të sigurojë të reduktohen gabimet dhe refuzimi i ofertave të plotësuara në mënyrë jo korrekte, të sigurohet krahasueshmëri më e mirë e çmimeve mesatare dhe analizës së tregut, të zvogëlohen mundësitë e manipulimit përmes automatizimit dhe shkëmbimit të centralizuar të të dhënave dhe duhet të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme transparenca e ofertave financiare, të reduktohet ose eliminohet tërësisht mundësia e gabimit aritmetik dhe të rritet mundësia e monitorimit dhe analizimit të të dhënave nga ana e Byrosë së Prokurimit Publik.

Përfaqësuesit e administratës komunale parashtruan pyetje të shumta për të cilat presin përgjigje në trajnimin e ardhshëm që do të organizohet nga ana e BNJVL-së dhe Byrosë së Prokurimit Publik në fillim të muajit të ardhshëm.









## УПРАВНИОТ ОДБОР НА ЗЕЛС ДИСКУТИРАШЕ ЗА КООРДИНИРАНОСТ НА СИТЕ ОПШТИНИ ПРИ СПРОВЕДУВАЊЕ НА ВОНРЕДНИ ИНСПЕКЦИСКИ КОНТРОЛИ ВО ОБЈЕКТИТЕ ОД ЈАВЕН КАРАКТЕР

Управниот одбор на ЗЕЛС, во проширен состав со градоначалници од неколку градови во земјава, на 24 март 2025 година, ја одржа дваесет и шестата седница. Главна тема на седницата беше координирањето на активностите што единиците на локалната самоуправа ги преземаат во врска со вонредните инспекциски контроли во објектите од јавен карактер, во нивна надлежност (училишта, градинки, спортски сали, културни институции) за утврдување на сигурноста и заштитата на граѓаните. На седницата беше заклучено општините кои располагаат со одредени инспекциски капацитети да ги стават на располагање и на другите општини, таму каде што има потреба, да се овозможи секоја општина темелно да изврши инспекциска контрола на сите објекти на својата територија. Беше нагласено дека поголем дел од општините вршат ваков редовен надзор, но дека овие вонредни инспекциски контроли се реакција на неодамнешната трагедија во Кочани, кога од избувнат пожар во кабаре, животот го загубија околу 60 млади лица, а приближно 200 лица беа повредени. Членовите на Управниот одбор, на

## BORDI DREJTUES I BNJVL-SË DISKUTOI PËR KOORDINIMIN E TË GJITHA KOMUNAVE GJATË ZBATIMIT TË KONTROLLEVE TË JASHTËZAKONSHME INSPEKTUESE NË OBJEKTET ME KARAKTER PUBLIK

Bordi drejtues i BNJVL-së, në përbërje të zgjeruar me kryetarë të disa qyteteve në vend, e mbajti seancën e njëzetegjashtë më 24 mars 2025. Tema kryesore në seancë ishte koordinimi i aktiviteteve që i ndërmarrin njësitë e vetëqeverisjes lokale në lidhje me kontrollet e jashtëzakonshme inspektuese në objektet me karakter publik që janë nën kompetencën e tyre (shkollat, kopshtet e fëmijëve, sallat sportive, institucionet kulturore) për përcaktimin e sigurisë dhe mbrojtjes së qytetarëve. Në seancë u konkludua që komunat të cilat kanë kapacitete të caktuara inspektuese t'i vënë në dispozicion për komunat e tjera, atje ku ka nevojë, të mundësohet që secila komunë tërësisht të kryejë kontroll inspektues mbi të gjitha objektet në territorin e saj. U theksua se pjesa më e madhe e komunave kryejnë një mbikëqyrje të këtillë të rregullt, por se këto kontrolle të jashtëzakonshme inspektuese vijnë si reagim ndaj tragjedisë së fundit në Koçan, kur nga zjarri i shpërthyer në një kabare humbën jetën rreth 60 personash të rinj, ndërsa rreth 200 personash u lënduan. Në fillim të seancës, anëtarët e Bordit drejtues shprehën

